ÇFARË NDODH PAS DIPLOMIMIT NGA SHKOLLA? REZULTATET NGA GJURMIMI I TË DIPLOMUARVE 2024–2025

Shkolla Profesionale “Nazmi Rushiti” Dibër

© 2026 Swisscontact

Rreth projektit "Aftësi për Punë" S4J

"Aftësi për Punë" S4J është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), i cili zbatohet në Shqipëri nga organizata Swisscontact. S4J adreson sfidat kryesore në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) në Shqipëri duke investuar për sigurimin e ndryshimeve sistematike, zhvillimin e kompetencave dhe fuqizimin e aktorëve. S4J mbështet ofruesit partnerë të AFP-së në drejtim të krijimit të lidhjeve të ngushta me kompanitë e sektorit privat dhe partnerë të tjerë, diversifikimit dhe përmirësimit të ofertës mësimore, aplikimit të metodave të reja të mësimdhënies dhe standardeve të cilësisë, realizimit të praktikave mësimore në mjediset e biznesit dhe zhvillimit e fuqizimit të institucionit.

Lista e tabelave

Tabela 1: Mbulimi i gjurmimit (2024–2025) 9
Tabela 2: Arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (2024–2025) 15
Tabela 3: Niveli i përdorimit të njohurive të fituara gjatë studimeve (2024–2025) 15
Tabela 4: Shkalla e lidhjes së pozicionit aktual të punës me studimet (2024–2025) 16
Tabela 5: Perceptimi për sigurinën dhe kënaqësinën në punën aktuale (2024–2025) 20
Tabela 7: Mënyrat e gjetjes së punës së parë (2024–2025) 21
Tabela 8: Ndihma e shkollës në gjetjen e punës së parë (2024–2025) 22
Tabela 8: Arsyet kryesore për ndjekjen e kualifikimeve të mëtejshme (2024–2025) 23
Tabela 9: Arsyet kryesore të papunësisë (2024–2025) 24
Tabela 10: Arsyet kryesore të mos kërkimit për punë (2024–2025) 25
Tabela 11: Përqindja e aspekteve ku ka nevojë për përmirësim në shkallë “shumë/jashtëzakonisht shumë” (2024–2025) 26
Tabela 12: Përzgjedhja e së njëjtës degë dhe shkollë sipas drejtimit (2024- 2025) 27
Tabela 13: Planet e të diplomuarve për dy vitet e ardhshme (2024–2025) 29

Lista e figurave

Figura 1: Shpërndarja sipas gjinisë (2025) 9
Figura 2: Shpërndarja sipas drejtimeve (2025) 9
Figura 3: Vendbanimi i të diplomuarve (2024-2025) 10
Figura 4: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2024) 11
Figura 6: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas drejtimeve (2025) 12
Figura 7: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas gjinisë (2025) 13
Figura 8: Lidhja e punës me fushën e arsimit (2024- 2025) 13
Figura 9: Lidhja e punës me fushën e arsimit sipas drejtimit (2024-2025) 14
Figura 10: Lidhja e punës me arsimin sipas gjinisë (2025) 14
Figura 11: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) 2025 16
Figura 12: Niveli i pagave sipas drejtimit (2025) 17
Figura 13: Niveli i pagave sipas gjinisë (2024-2025) 17
Figura 14: Punësimi me kohë të plotë përkundrejt punësimit me kohë të pjesshme (2024- 2025) 18
Figura 15: Madhësia e kompanisë (2024- 2025) 19
Figura 16: Lloji i kontratës (2024) 19
Figura 17: Ndërgjegjësimi rreth pagesës së sigurimeve nga punëdhënësi (2024- 2025) 19
Figura 23: Niveli i të diplomuarve pa punë që kërkojnë për punë (2024- 2025) 23
Figura 24: Metodat e kërkimit për punë (2024-2025) 25
Figura 25: Të diplomuarit papunë që kanë qenë në marrëdhënie pune (2024-2025) 25

Figura 26: Përzgjedhja e së njëjtës shkollë dhe degë (2024-2025) 27
Figura 27: Përzgjedhja e së njëjtës degë studimi dhe shkollë sipas gjinisë 2024-2025..... 28

SHKOLLA E MESME PROFESIONALE "NAZMI RUSHITI"

S4J Aftësi për Punë Skills for Jobs

Tabela e përmbajtjes

Lista e tabelave 3

Lista e figurave 3

Gjetjet kryesore 6

Çfarë është gjurmimi i të diplomuarve? 7

Të diplomuarit 2024–2025 9

Analiza e rezultateve 11

- Statusi i punësimit 11
- Lidhja e punës me fushën e arsimit 13
- Përdorimi i njohurive dhe kompetencave të fituara në shkollë në vendin e punës 15
- Niveli i pagave 16
- Kushtet e punës 18
- Perceptimet mbi stabilitetin dhe kënaqësia në vendin e punës 20
- Kohëzgjatja e gjetjes së punës së parë 21
- Mënyrat e gjetjes së punës së parë 21
- Të diplomuarit që ndjekin kualifikime të mëtejshme 23
- Të diplomuarit pa punë 23
- Propozimet për përmirësim në shkollë 26
- Planet për të ardhmen 28

Gjetjet kryesore

Ky raport krahasues paraqet rezultatet kryesore nga gjurmimi i të diplomuarve të shkollës profesionale Nazmi Rushiti për vitet 2024 dhe 2025.


- Në vitin 2025, 37% e të diplomuarve të gjurmuar ishin të punësuar/vetë-punësuar një vit pas diplomimit, kundrejt 33.3% në 2024 (+3.7 pikë përqindje).
- Niveli i papunësisë ra lehtësisht nga 47.2% (N=17) në 2024 në 44.4% (N=12) në 2025. Ndërkohë, pjesa e të papunëve që ishin aktivisht në kërkim të punës u rrit ndjeshëm, nga 64.7% në 2024 në 91.7% në 2025 (+27pp).
- Sipas drejtimit, Gjeologji Miniera vazhdon të ketë nivelin më të lartë të punësimit në të dy vitet (60% në 2024, 66.7% në 2025). Ekonomi Biznes u shfaq si drejtim me punësim të lartë në 2025 (50%), i para-raportuar veçanërisht në 2024. Papunësia mbetet e lartë në Ekonomi Biznes në të dy vitet (66.7% në 2024, 50% në 2025).
- Lidhja e punës me fushën e arsimit u përmirësua nga 30% në 2024 në 40% në 2025 (+10pp), megjithëse baza mbetet shumë e vogël në të dy vitet (N=10).
- 50% e të gjurmuarve në 2024 dhe 80% në 2025 pohojnë se i përdorin njohuritë dhe kompetencat e fituara në shkollë “shumë” ose “jashtëzakonisht shumë” (+30pp).
- Sipas rezultateve të gjurmimit për vitin 2025, struktura e të ardhurave mujore të të diplomuarve të punësuar paraqitet si më poshtë: 40% e të diplomuarve (N=4) raportojnë të ardhura në intervalin 50,001–60,000 lekë; ndërsa 20% (N=2) raportojnë të ardhura në intervalin 80,001–95,000 lekë. Pjesa tjetër shpërndahet në mënyrë të barabartë, me nga 10% (N=1) në secilën prej kategorive: deri në 50,000 lekë, 60,001–80,000 lekë, 95,001–120,000 lekë dhe mbi 120,000 lekë. Në përgjithësi, shumica dërrmuese e të diplomuarve (rreth 80%) kanë të ardhura mes 50,000 dhe 95,000 lekëve, ndërsa vetëm 10% arrijnë nivele mbi 120,000 lekë.
- Gjetja e punës para diplomimit u rrit ndjeshëm, nga 30% në 2024 në 50% në 2025 (+20pp).
- Perceptimi i sigurisë në punë u përmirësua nga 20% (2024) në 50% (2025) të atyre që ndjehen “të sigurt/shumë të sigurt”, dhe kënaqësia në punë u rrit nga 40% në 70% (+30pp).
- Nevoja për përmirësim në shkollë mbetet e lartë në të dy vitet, me theks te praktika në shkollë (55.2% në 2024, 60% në 2025) dhe bashkëpunimi me bizneset (51.7% në 2024, 52.2% në 2025).
- Brenda dy viteve të ardhshme, dëshira për të filluar biznesin personal u rrit nga 11.1% (2024) në 18.5% (2025), ndërsa dëshira për të qenë thjesht të punësuar u rrit më ndjeshëm, nga 30.6% në 59.3%.

Çfarë është gjurmimi i të diplomuarve?

Monitorimi i treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit e një institucioni arsimor realizohet përmes 'studimeve gjurmuese' që ndjekin ose 'gjurmojnë' **të diplomuarit** pasi ata diplomohen. Studimet e gjurmimit ofrojnë një tablo më të qartë të performancës së të diplomuarve të arsimit profesional në tregun e punës, duke matur punësimin produktiv të të diplomuarve pas përfundimit të studimeve.

Të dhënat dhe rezultatet e gjurmimit përdoren për të rritur kuptueshmërinë mbi **relevancën e ofertës** për kualifikime duke kontribuar kështu në zhvillimin e aftësive të kërkuara nga tregu i punës dhe në pajisjen e nxënësve me njohuritë dhe aftësitë e duhura. Tematikat e gjurmimit janë të shumëfishta, por kryesisht përfshijnë pyetje që lidhen me tranzicionin nga institucioni arsimor në tregun e punës, kushtet e punës, përputhjen midis arsimit dhe punës aktuale, si dhe vlerësimin në retrospektivë të institucionit arsimor nisur nga përvoja e të diplomuarve.

Avantazhet e një sistemi gjurmimi në nivel ofruesi



Në këtë kuadër, shkolla **Nazmi Rushiti Dibër**, me mbështetjen e projektit 'Aftësi për Punë' (S4J) ka ngritur një **sistem gjurmimi** në nivel ofruesi për të diplomuarit e saj. Ky sistem gjurmimi përmbush dy qëllime të rëndësishme:

a. Monitorimin e treguesve kryesorë të tregut të punës për të diplomuarit e shkollës.
b. Vlerësimin e lidhjes (përputhshmërisë horizontale) midis arsimit dhe punës.

Zbatimi i procesit të gjurmimit në praktikë zhvillohet në **tre faza kryesore** siç është e ilustruar në diagramën më poshtë.



Në fazën e para-gjurmimit, që kryhet në majin e çdo viti shkollor, realizohet para-gjurmimi i maturantëve që pritet të diplomohen në qershor. Para-gjurmimi kryhet me anë të një pyetësori të strukturuar online. Anketa mbledh të dhënat e kontaktit të maturantëve, karakteristikat e tyre socio-demografike, si dhe planet dhe pritshmëritë e tyre të karrierës për të mundësuar kështu gjurmimin e tyre një vit më pas.

Në fazën e gjurmimit, që kryhet në qershorin e çdo viti shkollor realizohet gjurmimi i të diplomuarve nga shkolla një vit më parë. Të diplomuarit raportojnë mbi përvojën e kalimit në tregun e punës dhe bëjnë vlerësimin në retrospektivë të shkollës së tyre përmes një pyetësori të standardizuar online duke përdorur platformën Kobo Toolbox.

Në fazën përmbyllëse të procesit analizohen rezultatet e gjurmimit dhe prezantohen rezultatet. Pjesa më e rëndësishme e procesit është leximi i këtyre gjetjeve dhe reflektimi i brendshëm i institucionit mbi të dhënat dhe ndërmarrja e hapave konkrete si rrjedhojë.

Procesi i gjurmimit koordinohet nga **koordinatori i gjurmimit** me mbështetjen e Njësisë së Zhvillimit dhe mësuesve kujdestarë, nën kujdesin e projektit ‘Aftësi për punë’.

Ky raport përmbledhës krahasues pasqyron rezultatet kryesore nga gjurmimi i brezave të diplomuar në vitin 2024 dhe në vitin 2025 në shkollën Nazmi Rushiti.

Të diplomuarit 2024–2025


Në vitin shkollor 2023–2024, në shkollën Nazmi Rushiti Dibër u diplomuan 40 nxënës, ndërsa në vitin shkollor 2024–2025 u diplomuan 30 nxënës (shiko tabelën 1).

Tabela 1: Mbulimi i gjurmimit (2024–2025)1

Brezi	Të diplomuar	Të anketuar	%
2023-2024	40	36	90%
2024–2025	30	27	90%

Nga të diplomuarit e vitit 2023–2024 u gjurmuan 36 nxënës (90%), ndërsa nga të diplomuarit e vitit 2024–2025 u gjurmuan 27 nxënës (90%), niveli i mbulimit mbeti i pandryshuar. Në 2024, 36.1% e të gjurmuarve ishin djem dhe 63.9% vajza; në 2025, 33.3% ishin djem dhe 66.7% vajza (Shiko figurën 1, grafik i pandryshuar).


Figura 1: Shpërndarja sipas gjinisë (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza 2025** (N=27)

Shpërndarja e të gjurmuarve sipas drejtimeve në 2024 (shih figurën 2, grafik i pandryshuar): 8.3% Ekonomi-Biznes, 2.1% Hoteleri Turizëm, 8.3% Teknologji Ushqimore, 11.1% TIK, 55.6% Shërbime Sociale dhe Shëndetësore, 13.9% Gjeologji Miniera. Në 2025, shpërndarja ndryshoi: 7.4% Ekonomi-Biznes, 14.8% TIK, 66.7% Shërbime Sociale dhe Shëndetësore, 11.1% Gjeologji Miniera, pa të diplomuar në Hoteleri Turizëm apo Teknologji Ushqimore.


Figura 2: Shpërndarja sipas drejtimeve (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: 2025 N=27

Të pyetur lidhur me vendbanimin (Shiko figurën 3), në 2024, 80.6% (N=29) e të diplomuarve jetonin në Shqipëri dhe 19.4% (N=7) jashtë vendit. Në 2025, 88.9% (N=24) jetonin në Shqipëri dhe 11.1% (N=3) jashtë vendit.

Figura 3: Vendbanimi i të diplomuarve (2024-2025)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2024** (N=36); **2025** (N=27)

Analiza e rezultateve

Statusi i punësimit


Sipas rezultateve të brezit 2023–2024, nga 36 të anketuar, 27.8% (N=10) ishin të punësuar, 5.6% (N=2) të vetëpunësuar, 11.1% (N=4) student/kursant, ndërsa 47.2% (N=17) ishin të papunë dhe 8.3% (N=3) zgjodhën opsionin “tjetër”. Në brezin 2024–2025, nga 27 të anketuar, 37% (N=10) ishin të punësuar (nuk ka tw vetwpunwsuar), 18.5% (N=5) student/kursant, ndërsa 44.4% (N=12) ishin të papunë.

Figura 4: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2024)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: 2025 N=27

Figura 5: Përfshirja në tregun e punës një vit pas diplomimit (2024- 2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2024** (N=36); **2025** (N=27)


Në figurën 6, jepet statusi i punësimit sipas drejtimeve. Në 2024, 25% e të diplomuarve në TIK, 35% në Shërbime Sociale dhe Shëndetësore dhe 60% në Gjeologji Miniera ishin të punësuar një vit pas diplomimit. Në 2025, 25% në TIK, 33.3% në Shërbime Sociale dhe Shëndetësore, 66.7% në Gjeologji Miniera dhe 50% në Ekonomi-Biznes ishin të punësuar.

Papunësia sipas drejtimit në 2024 ishte më e lartë në Hoteleri Turizëm (100%), Ekonomi Biznes (66.7%), Shërbime Sociale dhe TIK (50% për secën) dhe Teknologji Ushqimore (33.3%). Në 2025, papunësia mbeti më e lartë në Ekonomi Biznes dhe TIK (50% për secën), e ndjekur nga Shërbime Sociale (44.4%) dhe Gjeologji Miniera (33.3%).

Sikurse e tregon edhe figura 6, 33.3% e të diplomuarve në Ekonomi Biznes dhe Teknologji Ushqimore në 2024 zgjodhën të vijojnë studime të mëtejshme; në 2025, 25% në TIK dhe 22.2% në Shërbime Sociale bënë të njëjtën gjë.

Sikurse e tregon edhe figura 6, 33.3% e të diplomuarit në degën Ekonomi Biznes, 33.3% Teknologji Ushqimore dhe 10% Shërbime Sociale dhe Shëndetësore kanë zgjedhur të vijojnë studime të mëtejshme.


Figura 5: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas drejtimeve (2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2024 GJEO-MIN** (N=3); **SHER-SOC**(N=18); **TIK** (N=4); **EKO-BIZ** (N=2); **2025**: N= 10 **(**N_{TIK}=1; N_{TIK} = 1; $N_{SHER-SOC}$=6; $N_{GJEO-MIN}$=2)

Të ndara sipas gjinisë (shih figurën 7), të dhënat tregojnë se 55.6% e djemve janë të punësuar një vit pas diplomimit, ndërsa 27.8% e vajzave janë të punësuara. Pa punë janë 33.3% e djemve dhe 50% e vajzave. Ndërkohë, studime të mëtejshme ndjekin 11.1% e djemve dhe 22.2% e vajzave.

Figura 6: Statusi i punësimit një vit pas diplomimit sipas gjinisë (2025)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: M** (N=9); **F** (N=18)

Lidhja e punës me fushën e arsimit

Të pyetur nëse puna aktuale lidhet me fushën e tyre të arsimit, 25% e të diplomuarve në 2024 dhe 10% në 2025 u shprehën se puna lidhet me fushën e tyre të arsimit. Ndërsa 90% nw 2025 u shprehën që puna aktuale nuk lidhet me fushën e tyre të arsimit, nw 2024 me 75%.

Figura 7: Lidhja e punës me fushën e arsimit (2024- 2025)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **2024** (N=10); **2025** (N=10)

Të disagreguara sipas drejtimit, të dhënat tregojnë se lidhja e punës me fushën e arsimit mbetet shumë e dobët në pothuajse çdo drejtim, në të dy vitet. Në total, vetëm 25% e të punësuarve (N=3

nga 12) raportuan lidhje me arsimin në 2024, duke rënë në 10% (N=1 nga 10) në 2025. Gjeologji Miniera mbetet i drejtimi me lidhje, por edhe këtu vërehet rënie: nga 75% (N=3 nga 4) në 2024 në 50% (N=1 nga 2) në 2025. Në TIK dhe Shërbime Sociale dhe Shëndetësore, mospërputhja mbetet totale në të dy vitet (100% "Jo"). Në përgjithësi, të dhënat sugjerojnë një thellim të boshllëkut mes arsimimit dhe tregut të punës nga 2024 në 2025, në pothuajse të gjitha drejtimet.


Figura 8: Lidhja e punës me fushën e arsimit sipas drejtimit (2024-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. ; **Baza: N=12 (**N_{TIK}=1; $N_{SHER\text{-}SOC}$=7; $N_{GJEO\text{-}MIN}$=4) **2025**: N= 10 **(**N_{TIK}=1; N_{TIK} = 1; $N_{SHER\text{-}SOC}$=6; $N_{GJEO\text{-}MIN}$=2)

Të ndara sipas gjinisë, lidhja e punës me fushën e arsimit ra për të diplomuarit meshkuj nga 2024 në 2025: në 2024, 37.5% e të diplomuarve të gjinisë mashkullore ishin të punësuar në një punë që lidhet me fushën e tyre të arsimit, ndërsa në 2025 kjo pjesë ra në 20%. Përkatësisht, pjesa e meshkujve të punësuar në punë që nuk lidhet me arsimimin e tyre u rrit nga 62.5% në 80% nw 2025. Për gjininë femërore, situata mbeti e pandryshuar dhe krejtësisht negative në të dy vitet: 100% e të diplomuarve femra ishin të punësuara në punë që nuk lidhej fare me fushën e tyre të arsimit, si në 2024 ashtu edhe në 2025.

Figura 9: Lidhja e punës me arsimin sipas gjinisë (2024-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2024; M** (N=13); **F** (N=23); 2025: **M** (N=9); **F** (N=18);

Të pyetur lidhur me arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (shiko tabelën 2), të diplomuarit e brezit 2024 përmendën kryesisht pamundësinë për të gjetur një vend pune që lidhet me studimet (71.4%) dhe pagën/kushtet më të mira të punës aktuale (28.6%). Në 2025, arsyet u ndanë barazërisht mes pamundësisë për të gjetur punë në fushë (50%) dhe mungesës së dëshirës për të punuar në fushën e studimeve.

Tabela 2: Arsyet e mospërputhjes së punës me fushën e arsimit (2024–2025)2

	2024	2025
Nuk gjeta një vend pune që lidhet me studimet e mia	71.4%	50%
Puna që kam më ofron pagë/kushte më të mira	28.6%	-
Nuk dua të punoj në një punë që lidhet me studimet e mia	-	50%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2024** (N=7); **2025** (N= 17)

Përdorimi i njohurive dhe kompetencave të fituara në shkollë në vendin e punës

Të pyetur nëse njohuritë dhe kompetencat e fituara gjatë studimit i përdorin në vendin e punës (shiko tabelën 3), rezultatet tregojnë se njohuritë përdoren “shumë/jashtëzakonisht shumë” nga 50% e të gjurmuarve në 2024 dhe 80% në 2025.

Në 2024, 25% e të diplomuarve përdorin “aspak” njohuritë e fituara; kjo kategori nuk u raportua fare në 2025.

Tabela 3: Niveli i përdorimit të njohurive të fituara gjatë studimeve (2024–2025)3

	Aspak	2	3	4	Jashtëzakonisht shumë
2024	25%	25%	33.3%	0%	16.7%
2025	0%	20%	40%	20%	20%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2024** (N=12); **2025** (N=10)

Të pyetur për lidhjen mes pozicionit të punës dhe studimeve të kryera (shiko tabelën 4), 33.3% e të diplomuarve në 2024 e vlerësojnë këtë lidhje me “shumë/jashtëzakonisht shumë”, kundrejt 70% në 2025. Vlerësimi “aspak” ra nga 41.7% në 2024 në 0 në 2025.

Tabela 4: Shkalla e lidhjes së pozicionit aktual të punës me studimet (2024–2025)4

	Aspak	2	3	4	Jashtëzakonisht shumë
2024	41.7%	25%	25%	0%	8.3%
2025	0%	30%	30%	40%	0%


Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2024** (N=12); **2025** (N=10)

Niveli i pagave

Përsa i përket nivelit të pagave për të diplomuarit e punësuar, një vit pas diplomimit, struktura e të ardhurave ndryshoi mes viteve (shiko figurën 11). Në 2024: 25% me pagë minimale deri 40,000 lekë, 16.7% në fashën 40,001–50,000 lekë, 16.7% në 50,001–60,000 lekë, 8.3% në 60,001–80,000 lekë, 25% në 80,001–95,000 lekë dhe 8.3% mbi 120,000 lekë.

Sipas rezultateve për vitin 2025, struktura e të ardhurave mujore të të diplomuarve të punësuar paraqitet si më poshtë: 40% e të diplomuarve (N=4) raportojnë të ardhura në intervalin 50,001–60,000 lekë; ndërsa 20% (N=2) raportojnë të ardhura në intervalin 80,001–95,000 lekë. Pjesa tjetër shpërndahet në mënyrë të barabartë, me nga 10% (N=1) në secilën prej kategorive: deri në 50,000 lekë, 60,001–80,000 lekë, 95,001–120,000 lekë dhe mbi 120,000 lekë. Në përgjithësi, shumica dërrmuese e të diplomuarve (rreth 80%) kanë të ardhura mes 50,000 dhe 95,000 lekëve, ndërsa vetëm 10% arrijnë nivele mbi 120,000 lekë. Në përgjithësi, pjesa e të diplomuarve me të ardhura të larta duket të jetë rritur në 2025.

Figura 10: Niveli i pagave një vit pas diplomimit (net) 2025




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: N=10

Sipas të dhënave të disagreguara sipas drejtimit të diplomimit (shih Figura 12), vërehet se 16.7% të diplomuarve në Shërbime Sociale dhe Shëndetësore marrin një pagë deri në 50,000 Lekë. Ndërkohë, 33.3% e të diplomuarve në të njëjtin drejtim marrin një pagë 50,001–60,000 Lekë, ndërsa e njëjta pagë karakterizon edhe 50.0% të të diplomuarve në Gjeologji Miniera dhe 100.0% të të diplomuarve në TIK. Për sa i përket intervalit 60,001–80,000 Lekë, vetëm 16.7% e të diplomuarve në Shërbime Sociale dhe Shëndetësore e raportojnë këtë nivel page.

Gjithashtu, pagë 80,001–95,000 Lekë marrin 16.7% e të diplomuarve në Shërbime Sociale dhe Shëndetësore, si dhe 50.0% e të diplomuarve në Gjeologji Miniera.

Intervali 95,001–120,000 Lekë përfaqësohet tërësisht nga të diplomuarit në Ekonomi-Biznes (100.0%). Për më tepër, vetëm 16.7% e të diplomuarve në Shërbime Sociale dhe Shëndetësore marrin një pagë mbi 120,000 Lekë.

Figura 11: Niveli i pagave sipas drejtimit (2025)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: **2025**: N= 10 **(**N_{TIK}=1; N_{TIK} = 1; $N_{SHER\text{-}SOC}$=6; $N_{GJEO\text{-}MIN}$=2)

Të dhënat sipas gjinisë tregojnë ndryshime të ndjeshme mes viteve, veçanërisht te vajzat. Në 2024, pagat e vajzave ishin të përqendruara në nivelet më të ulëta: 50% deri në 40,000 lekë dhe 50% në intervalin 40,001–50,000 lekë. Në 2025, shpërndarja e vajzave u zgjerua ndjeshëm drejt niveleve më të larta: pagat u shpërndanë në mënyrë të barabartë (20% për secilën kategori) në intervalet deri në 50,000 lekë, 50,001–60,000 lekë, 60,001–80,000 lekë, 95,001–120,000 lekë dhe mbi 120,000 lekë.

Te djemtë, në 2024 pagat ishin më të shpërndara: 12.5% deri në 40,000 lekë, 25% në 50,001–65,000 lekë, 12.5% në 60,001–80,000 lekë, 37.5% në 80,001–95,000 lekë dhe 12.5% mbi 120,000 lekë. Në 2025, shpërndarja u përqendrua në vetëm dy kategori: 60% në intervalin 50,001–65,000 lekë dhe 40% në 80,001–95,000 lekë.

Figura 12: Niveli i pagave sipas gjinisë (2024-2025)




Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: 2024: 12 (N_M=8; N_F=4); 2025 N=10 (M= 3; F=7)

Kushtet e punës

Të pyetur lidhur me karakteristikat kryesore të punës, 90% e të diplomuarve në 2024 punonin me kohë të plotë (10% kohë të pjesshme). Në 2025, 60% punonin me kohë të plotë, 20% me kohë të plotë sezonale dhe 20% me kohë të pjesshme, një rënie e punësimit me kohë të plotë të qëndrueshme.


Figura 13: Punësimi me kohë të plotë përkundrejt punësimit me kohë të pjesshme (2024- 2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2024** (N=10); **2025**: (N= 10)

Për sa i përket shpërndarjes së të diplomuarve sipas tipologjisë së kompanisë (shiko figurën 15), në 2024, 20% punonin në kompani me 1–4 punonjws, 40% me 5–9 dhe 40% me mbi 50 punonjws. Në 2025, shpërndarja u ba më e barabartë: 20% në 1–4 punonjws, 40% në 5–9, 20% në 10–49 dhe 20% në mbi 50 punonjws.

Figura 14: Madhësia e kompanisë (2024- 2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2024** (N=10); **2025** (N=10)


Lidhur me llojin e kontratës, në 2024, 20% e të gjurmuarve kishin kontratë me afat të caktuar, 60% me afat të pacaktuar dhe 20% pa kontratë. Në 2025, asnjë nuk raportoi kontratë me afat të caktuar, 40% kishin kontratë me afat të pacaktuar dhe shumica (60%) punonin pa kontratë.

Figura 15: Lloji i kontratës (2024)

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2024** (N=10)

Lidhur me pagesën e kontributeve të detyrueshme nga punëdënësi (shiko figurën 17), 80% e të diplomuarve të punësuar në 2024 dhe po 80% në 2025 deklaruan se iu paguheshin — nivel i pandryshuar mes viteve.

Figura 16: Ndërgjegjësimi rreth pagesës së sigurimeve nga punëdhënësi (2024- 2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2024** (N=10); **2025** (N=10)

Perceptimet mbi stabilitetin dhe kënaqësia në vendin e punës

Të pyetur se sa të sigurt dhe të stabilizuar ndjeheshin në vendin e tyre të punës (shiko tabelën 5), 20% e të diplomuarve në 2024 dhe 50% në 2025 u shprehën se ndjehen "të sigurt" ose "shumë të sigurt". Pjesa e atyre që u shprehën "të pasigurt" ose "shumë të pasigurt" ra nga 50% (2024) në 40% (2025).

Të pyetur lidhur me kënaqësinë në vendin e punës, 40% e të diplomuarve në 2024 dhe 70% në 2025 u shprehën se ndjehen "të kënaqur" ose "shumë të kënaqur". Pjesa e "shumë të pakënaqurve" mbeti e njëjtë, 10% në të dy vitet.

Tabela 5: Perceptimi për sigurinën dhe kënaqësinën në punën aktuale (2024–2025)5

	2024	2025
Shumë i/e pasigurt	30%	20%
I/e pasigurt	20%	20%
As i sigurt as i pasigurt/ neutral	30%	10%
I/e sigurt	10%	40%
Shumë i/e sigurt	10%	10%
I/e pakënaqur	10%	10%
As i kënaqur as i pakënaqur/ neutral	50%	20%
I/e kënaqur	10%	50%
Shumë i/e kënaqur	30%	20%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2024** (N=12); **2025** (N=10)

Kohëzgjatja e gjetjes së punës së parë

Të pyetur për kohën që u duhet të presin derisa të fillojnë punën e tyre të parë, 30% e të diplomuarve në 2024 dhe 50% në 2025 u përgjigjën se e kishin gjetur punën para diplomimit. Në 2024, 30% u punësuan brenda 1 muaji nga diplomimi (10% në 2025), 20% brenda 1–3 muajsh (10% në 2025), ndërsa 20% në të dy vitet u punësuan 9–12 muaj pas diplomimit. Në përgjithësi, procesi i gjetjes së punës së parë u shpejtua ndjeshëm nga 2024 në 2025.

Tabela 6: Periudha kohore në kërkim të një pune (2024- 2025)

Periudha	2024	2025
Para diplomimit / menjëherë	30%	50%
1 muaj pas diplomimit	30%	10%
1–3 muaj	20%	10%
3–6 muaj		10%
6–9 muaj		10%
9–12 muaj	20%	20%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: 2024; N=12, 2025: N=10

Mënyrat e gjetjes së punës së parë

Të pyetur për mënyrën e gjetjes së punës së parë, në 2024, 30% gjetën punë nga lidhjet personale dhe 30% nga njoftimet online. Në 2025, 50% gjetën punë nga njoftimet online dhe 40% nga lidhjet personale një rritje e përgjithshme e përdorimit të kanaleve formale/online të kërkimit.

Në 2024, 10% gjetën punë duke kontaktuar drejtpërdrejt punëdhënësin dhe po aq nga praktika profesionale në biznes; 20% nga zyra e punësimit. Në 2025, vetëm praktika profesionale në biznes u përmend (10%); kontakti direkt me punëdënësin dhe zyra e punësimit nuk u raportuan fare.

Tabela 7: Mënyrat e gjetjes së punës së parë (2024–2025)6

	2024	2025
Nga njoftimet për punë në faqe interneti, media sociale, gazetë	30%	50%
Nga njohjet, lidhjet familjare, miqtë	30%	40%
Nga praktika profesionale në biznes	10%	10%
Duke kontaktuar drejtpërdrejtë me punëdënësin tim	10%	-
Nga zyra e punësimit	20%	-

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2024** (N=12); 2025 (N=10)

Lidhur me mënyrat e mbështetjes së shkollës në kapërcimin e fazës tranzitore drejt tregut të punës (shiko tabelën 7), në 2024, 25% pohuan se shkolla i ka mësuar si të aplikojnë për punë dhe 25%

pohuan se i ka orientuar mbi mundësitë e punësimit. Në 2025, këto përqindje u rritën në 30% dhe 50% përkatësisht. Pjesa e atyre që pohojnë se shkolla “përgjithësisht nuk i ka ndihmuar” ra nga 33.3% (2024) në 20% (2025).

Tabela 8: Ndihma e shkollës në gjetjen e punës së parë (2024–2025)7

	2024	2025
Kam mësuar si të kërkoj dhe të aplikoj për punë	25%	30%
Më ka orientuar mbi mundësitë e ndryshme të punësimit	25%	50%
Më ka ndihmuar për të vendosur kontakte me punëdënës potencialë	8.3%	-
Përgjithësisht nuk më ka ndihmuar	33.3%	20%
Tjetër	16.7%	10%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2024 (**N=12), **2025** (N=10)

Të diplomuarit që ndjekin kualifikime të mëtejshme

Në 2024, 11.1% (N=4) e të diplomuarve të gjurmuar ishin student/kursant, kundrejt 18.5% (N=5) në 2025 .

Në 2024, të gjithë të diplomuarit që ndiqnin kualifikime të mëtejshme kishin zgjedhur universitetin (4 nga 4, 100% në institucione publike). Në 2025, 60% zgjodhën universitetin dhe 40% një kurs profesional; 60% studiojnë në institucione publike dhe 40% në private, një larmi më e madhe krahasuar me 2024.

Të pyetur nëse studimet që po ndjekin lidhen me shkollën e mëparshme, 100% u shprehën po në 2024, kundrejt 80% në 2025 (shiko figurën 22).

Të pyetur mbi arsyet e ndjekjes së studimeve të mëtejshme (shiko tabelën 9), në 2024, 50% u përgjigjën për të fituar një kualifikim më të lartë. Në 2025, arsyeja kryesore u bë rritja e mundësive për të gjetur një punë më të mirë (50%, nga 25% në 2024), ndërsa kualifikimi më i lartë ra në 20%.

Tabela 8: Arsyet kryesore për ndjekjen e kualifikimeve të mëtejshme (2024–2025)8


	2024	2025
Për të fituar një kualifikim më të lartë	**50%**	**20%**
Për të rritur mundësitë për të gjetur një punë më të mirë	**25%**	**50%**
Për të ndjekur një karrierë tjetër profesionale	**25%**	**25%**

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: **2024** (N=4), 2025 (N=5).

Të diplomuarit pa punë

Niveli i të diplomuarve të papunë një vit pas diplomimit ra lehtësisht nga 47.2% (N=17) në 2024 në 44.4% (N=12) në 2025. Pjesa e të papunëve aktivisht në kërkim të punës u rrit ndjeshëm, nga 64.7% (11 nga 17) në 2024 në 91.7% (11 nga 12) në 2025.

Figura 17: Niveli i të diplomuarve pa punë që kërkojnë për punë (2024- 2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: **2024** (N=17)

Në 2024, arsyet kryesore të papunësisë ishin mungesa e njohjeve/kontakteve të duhura (45.5%) dhe mungesa e eksperiencës në punë (27.3%). Në 2025, arsyeja e vetme e raportuar nga të gjithë të papunët (100%) ishte mospërputhja mes njohurive të marra në shkollë dhe kërkesave të tregut të punës — një arsye që nuk ishte raportuar fare në 2024.


Tabela 9: Arsyet kryesore të papunësisë (2024–2025)9

	2024	2025
Më mungon eksperienca e punës	27.3%	-
Nuk kam njohjet/kontaktet e duhura për të gjetur një punë	45.5%	-
Nuk ka punë në qarkun tim	9.1%	-
Nuk di si të kërkoj për punë	9.1%	-
Tjetër	9.1%	-
Njohuritë që kam marrë nga shkolla nuk përputhen me tregun e punës	-	100%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: **2024** (N=11), 2025 N= 12

Të pyetur rreth formave që përdorin për të kërkuar një vend pune (shiko figurën 24), rezulton se njoftimet për punë në faqe interneti, media sociale dhe gazetë u bënë kanali kryesor i gjetjes së punës në 2025, duke u rritur nga 33.3% në 2024 në 50%. Njohjet dhe lidhjet familjare/miqësore gjithashtu u rritën, nga 33.3% në 40% , duke mbetur kanali i dytë më i përdorur në të dy vitet. Praktika profesionale në biznes mbeti relativisht e qëndrueshme (11.1% në 2024, 10% në 2025). Në ndryshim nga 2024, kontakti i drejtpërdrejtë me punëdhënësin dhe Zyra e Punësimit , secili me nga 11.1% në 2024, nuk u raportuan fare si kanale në 2025.

Figura 18: Metodat e kërkimit për punë (2024-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2020** (N=13), **2025** N=10

Në 2024, arsyet kryesore të mos-kërkimit të punës ishin mungesa e dëshirës për të punuar (50%) dhe mungesa e besimit se do gjenin punë (16.7%). Në 2025, i vetmi rast i raportuar (100% e një grupi shumë të vogël, N=1) ishte mungesa e besimit se do gjente punë.


Tabela 10: Arsyet kryesore të mos kërkimit për punë (2024–2025)10

	2024	2025
Nuk kam besim se do gjej një punë	16.7%	100%
Nuk kam dëshirë të punoj për momentin	50%	-
Kujdesem për fëmijët/famiiljen	16.7%	-
Tjetër	16.7%	-

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2024** (N=6), 2025 (N= 1)

Për sa i përket përvojës së mëparshme të punës, 23.5% e të diplomuarve të papunë në 2024 dhe 25% në 2025 kanë pohuar se kanë qenë në një marrëdhënie pune më parë.

Figura 19: Të diplomuarit papunë që kanë qenë në marrëdhënie pune (2024-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza**: **2024** (N=17), **2025** (N=12).

Propozimet për përmirësim në shkollë

Të pyetur se për çfarë aspektesh ka nevojë për përmirësim shkolla (shiko tabelën 11), nevoja mbetet e lartë në të dy vitet në pothuajse çdo aspekt. Në 2024, theksi ishte tek praktika në biznes (60.7%), bashkëpunimi me bizneset (51.7%) dhe praktika në shkollë (55.2%). Në 2025, praktika në biznes ra në 40.9%, ndërsa aftësitë teorike/praktike të mësuesve u rritën ndjeshëm nga 42.9% në 59.1% dhe këshillimi i karrierës nga 30% në 50%.


Tabela 11: Përqindja e aspekteve ku ka nevojë për përmirësim në shkallë "shumë/jashtëzakonisht shumë" (2024–2025)11

	2024	2025
Infrastruktura	40.7%	30.4%
Kurrikula	25%	39.1%
Tekstet dhe materialet	40%	45.5%
Metodat e mësimdhënies	50%	41.7%
Aftësitë teorike dhe praktike të mësuesve	42.9%	59.1%
Praktika në shkollë	55.2%	60%
Praktika në biznes	60.7%	40.9%
Këshillimi i karrierës	30%	50%
Bashkëpunimi me bizneset	51.7%	52.2%
Bashkëpunimi me zyrat e punësimit	46.4%	50%

Shënim: Kjo është pyetje ku janë marrë të dhënat e të diplomuarve që janë përgjigjur "shumë/jashtëzakonisht shumë". Shuma e përqindjeve nuk është e barabartë me 100%. **Baza**: **2024, 2025**

Nëse do të kishin mundësi, 69.4% e të diplomuarve në 2024 do të zgjidhnin të njëjtin drejtim profesional dhe 88.9% të njëjtën shkollë. Në 2025, 77.8% do të zgjidhnin të njëjtin drejtim, ndërsa vetëm 74.1% do të zgjidhnin të njëjtën shkollë (shiko figurën 26).

Figura 20: Përzgjedhja e së njëjtës shkollë dhe degë (2024-2025)



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2024** (N=36);

Të disagreguara sipas drejtimeve, përzgjedhja e së njëjtës degë dhe shkollë ndryshoi ndjeshëm nga 2024 në 2025, me rënie në shumicën e drejtimeve. Për degë, rënia më e madhe u vu re te Ekonomi Biznes nga 100% në 50% dhe TIK nga 100% në 75%, ndërsa Teknologji Ushqimore ra nga 33.3% në 0%. Shërbime Sociale dhe Shëndetësore ishte i vetmi drejtim me rritje (nga 65% në 83.3%), ndërsa Gjeologji Miniera ra lehtësisht nga 80% në 66.7%. Hoteleri Turizëm mbeti në 0% në të dy vitet.

Për shkollën, ndryshimi ishte edhe më i theksuar: Teknologji Ushqimore ra nga 66.7% në 0%, TIK nga 100% në 50% dhe Gjeologji Miniera nga 100% në 66.7% . Ekonomi Biznes mbeti i vetmi drejtim me përzgjedhje të plotë të pandryshuar (100% në të dy vitet), ndërsa Shërbime Sociale dhe Shëndetësore ra lehtë (nga 85% në 77.8%). Në përgjithësi, të dhënat sugjerojnë një ulje të nw përzgjedhjen fillestare në pothuajse çdo drejtim, veçanërisht te Teknologji Ushqimore dhe TIK.


Tabela 12: Përzgjedhja e së njëjtës degë dhe shkollë sipas drejtimit (2024- 2025)12

		Ekonomi Biznes	Hoteleri Turizëm	Teknologji Ushqimore	TIK	Shërbime Sociale dhe Shëndetëso re	Gjeologji Miniera
2024	Degë	100%	0%	33.3%	100%	65%	80%
	Shkollë	100%	100%	66.7%	100%	85%	100%
2025	Degë	50%	0%	0%	75%	83.3%	66.7%
	Shkollë	100%	0%	0%	50%	77.8%	66.7%

Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza 2024:** N_{EK-BIZ}=3; $N_{HOT=TUR}$=1; $N_{TEK=USH}$=; N3$_{TIK}$=4; $N_{SHER=SOC}$=20, $N_{GJEO=MIN}$=5, **2025**: N= 10 **(**N_{TIK}=1; N_{TIK} = 1; $N_{SHER-SOC}$=6; $N_{GJEO-MIN}$=2)

Të ndara sipas gjinisë, përzgjedhja e së njëjtës degë u përmirësua për të dyja gjinitë nga 2024 në 2025, por veçanërisht për vajzat: te meshkujt u rrit lehtësisht nga 76.9% në 77.8% , ndërsa te femrat u rrit ndjeshëm nga 65.2% në 72.2%, duke ngushtuar dallimin gjinor në këtë tregues. Për shkollën, situata ishte e kundërt: te meshkujt përzgjedhja ra ndjeshëm nga 100% (2024) në 77.8% (2025), ndërsa te femrat mbeti pothuajse e pandryshuar (82.6% në 2024, 77.8% në 2025). Në përgjithësi, në 2025 dallimi gjinor u ngushtua dhe të dyja gjinitë konverguan drejt niveleve më të ngjashme (rreth 72-78%) për të dy treguesit, ndërsa në 2024 meshkujt ishin dukshëm më besnikë ndaj shkollës (100% kundrejt 82.6% të femrave).

Figura 21: Përzgjedhja e së njëjtës degë studimi dhe shkollë sipas gjinisë 2024-2025



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakosur në numrin e plotë më të afërt. Si pasojë e rrumbullakosjes, shuma e përqindjeve jo gjithmonë është e barabartë me 100%. **Baza: 2024 N= 37=6, 2025 N=27**

Planet për të ardhmen

Të pyetur për planet e tyre për të ardhmen e afërt (shiko tabelën 13), dëshira për të qenë thjesht të punësuar u rrit ndjeshëm, nga 30.6% (2024) në 59.3% (2025), duke u bërë prioriteti kryesor në 2025. Dëshira për të filluar biznesin personal u rrit gjithashtu, nga 11.1% në 18.5% .

Nëse në 2024 36.1% e të diplomuarve dëshironin të ndiqnin studime të mëtejshme, në 2025 kjo pjesë ra në 25.9%. Dëshira për të gjetur punë të lidhur me fushën e studimit mbeti thuajse e njëjtë (38.9% në 2024, 40.7% në 2025), ndërsa dëshira për emigrim jashtë vendit ra lehtësisht (5.6% në 2024, 3.7% në 2025).

Tabela 13: Planet e të diplomuarve për dy vitet e ardhshme (2024–2025)13

	2024	2025
Të jem punësuar	30.6%	59.3%
Të kem gjetur një punë që të lidhet me fushën time të studimit	38.9%	40.7%
Të kem filluar biznesin tim	11.1%	18.5%
Të kem ndjekur studime të mëtejshme	36.1%	25.9%
Të kem emigruar jashtë vendit	5.6%	3.7%
Të kem migruar në një qytet tjetër brenda vendit	5.6%	-
Tjetër	2.8%	-

Shënim: Kjo është pyetje me përgjigje të shumëfishta. Shuma e përqindjeve nuk është e barabartë me 100%. **Baza**: **2024** (N=36), **2025** (N=27)